



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Zyra e Kryetarit të Komunës

Pranuar me: Priljeno:	31.05 20 23	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-052/01-	27672	

Projekt-Plani Komunal Për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Përsonave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Lipjanit 2023-2025

Projekt-Planin Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Lipjanit 2023-2025

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739 e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, komisioni i formuar me vendim të kryetarit të komunës ka punuar në Projekt-Planin Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Lipjanit 2023-2025 dhe në bashkëpunim me sektorin për marrëdhënie me publikun kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Projekt-Planin Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Lipjanit 2023-2025

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik Ky projekt Plan si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41829>

Projekt-Planin Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Lipjanit 2023-2025

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Ndërsa takimi konsultativ është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. 22.05.2023 u mbajt në sallën e Komunës së Lipjanit duke filluar nga ora 10:00.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

Në ueb faqe:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/news/diskutohet-projekt-planin-komunal-per-ri-integrimin-e-qendrueshem-te-personave-te-riatdhesuar-dhe-integrimin-e-te-huajve-ne-komunen-e-lipjanit-2023-2025/>

Nën kryesimin e Shkelzen Hajdini kryesues i komisionit për hartimin e këtij Plani u hap takimi me ç'rast ai ka përshëndetur të gjithë të pranishmit duke i falenderuar për pjesëmarrje si dhe prezantoi anëtarët e komisionit të cilët hartuan hertimin e këtij Plani.

1. Shkelzen Hajdini-Drejtor për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,Kryesues i Grupit
2. Lidija Jovanovic– Zyra Lokale për Komunitete,antar
3. Zoran Stanojevic– Zyra Lokale për Komunitete ,antar
4. Brahim Duriqi - Drejtorati për Arsim,antar
5. Behar Aliu - Drejtorati për Administratë,antar

Konsultimi publik u zhvillua në prezencën e një numër të konsideruar të pjesëmarrësve, me ç'rast kryesuesi Hajdini ka theksuar se me qëllim që t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse, ka prezantuar Projekt-Planin Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Lipjanit 2023-2025.

Projekt-Planin Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Lipjanit 2023-2025

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Kryesuesi Shkelzen Hajdini, po ashtu ka theksuar se Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv, saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve, indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteteve dhe mjetet e verifikimit, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riatdhesuar në Komunën e Lipjanit përmban edhe aktivitetet specifike për vetë komunën dhe është e bazuar në të dhënat e siguruara nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Kështu, në këtë Plan është mundësuar integrimi maksimal i gjitha aktiviteteve për arritjen e ri integritetit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Lipjanit.

Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë qështje, lidhur me të riatdhesuarit në Komunën e Lipjanit



Projekt-Planin Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Lipjanit 2023-2025

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Gjatë këtij debati ka pasur edhe angazhime nga të pranishmit ku është diskutuar për çështjet të ndryshme dhe kanë kërkuar nga komisioni sqarime rreth këtij dokumenti.

Hyra Bytyqi: Ka pyetur se nëse ky plan ka ndonjë ndryshim në krahasim, me planet e mëparshme të përgatitura për rintegrimin e personave të riatdhesuar dhe pyeti për 3 shtëpi që janë ndërtuar për familjet e riatdhesuar në pronën komunale në Medvec dhe në të cilat nuk jeton askush.

Lidija Jovanovic u përgjigj se në planet e mëparshme ka pasur ndryshime është miratuar planit për riintegrimin e personave të riatdhesuar, ndërsa këtij plani i është shtruar i integrimi i të huajve, ndërsa për shtëpitë bosh kemi bërë një raport të detajuar për gjendjen e atyre dhe to të shohim tutje se qka do të veprojmë.

Lumnije Zeqiri : Ka pyetur për ndërtimin e shtëpive në Babush i Serbeve, që shtëpitë të mos mbeten bosh si në atë vend.

Anëtarët e Komisionit janë përgjigjur se sot është prezantuar plani komunal për riintegrim, se janë ndërtuar shtëpi në Babush i Serbeve për të kthyerit. Sa i përket riintegrimit, ZKKK është duke punuar me të gjitha komunitetet dhe të bëjmë zgjedhje edhe për ta, po ashtu tani janë ndërtuar shtëpi për familjet e riatdhesuar në Sllovi, Smallush, Ribar, Magur, Medvec, Kraisht dhe vende të tjera.

Besiana Zeqiri: Ka pyetur për numrin e personave të riatdhesuar dhe sa do të ju dal në ndihmë Komuna e Lipjanit.

Lidija Jovanovic u përgjigj nga viti 2010 deri tash kemi ma shumë nga 350 familja ose ma shumë nga 1000 persona të riatdhesuar dhe Komuna e Lipjanit me të gjitha kapacitetet e saja po mundohet të ju dal në ndihmë atyre.

Lulzim Qerimi: Komuna e Lipjanit e ndihmuar kohe pas kohe nga niveli qendror ka ofruar mbështetje në të gjitha format për komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas, por që mbetet e nevojshme një mbështetje e tillë edhe më tutje.

Lidija Jovanovic si dhe anëtarët e tjerë të komisionit kanë theksuar se kordinimi me nivelin lokal dhe atë qendror është vazhdimisht i mirë.

Takimi në ora 11:30

Projekt-Planin Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Lipjanit 2023-2025

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuuesve
30 ditë pranohen		17
30 ditë		

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **17** pjesëmarrës, prej tyre **10** femra dhe **7** meshkuj.

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike

